

INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT, SEKSIONI I ADMINISTRATËS, NDOQI PROBLEMATIKËN E ANKUESIT A.T., ETJ, NGA QYTETI I FIERIT, LIDHUR ME NIVELIN E NDOTJES NË ZONËN NAFTËNXJERRËSE TË MARINZËS. ETJ.

Institucioni i Avokatit të Popullit, Seksioni i Administratës, në ushtrim të kompetencave kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave themelore të shtetasve shqiptarë, vijon të ndjekë me prioritet dhe kujdes çështjen e nivelit të ndotjes në vendburimet/zonat gaz dhe naftënxjerrëse të Shqipërisë.

Pas hetimit administrativ, duke vlerësuar të drejtë e të bazuar në ligj shqetësimin e individit ankues, Institucioni Avokatit të Popullit i është drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me rekomandim për:

- *Përmirësimin e metodologjisë së monitorimit të cilësisë së ajrit, ujit, tokës në vendbanimet e ndodhura pranë zonave ku ushtrohet veprimtari për nxjerrjen e naftës e gazit si dhe informimin e vazhdueshëm të publikut mbi treguesit e nivelit të pastërsisë së mjedisit në këto zona;*
- *Krijimin e një qendre për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të monitorimit në zonat naftë dhe gaz mbajtëse si dhe publikimin e tyre.*

Nisur nga rëndësia e mjedisit, i cili mund të ekzistoj pa ne, por jo ne pa të, është gjykuar e vlerësuar përgatitja dhe dërgimi pranë organeve kompetente shtetërore i rekomandimeve për zhvillimin e praktikave të cilat mundësojnë parandalimin dhe ruajtjen e mjedisit në vendburimet/zonat gaz dhe naftënxjerrëse. Mjedisi është i të gjithëve dhe të gjithë duhet ta mbrojnë atë. Shoqëria si në vendin tonë ashtu edhe në mbarë botën po përballlet me probleme të mëdha që lidhen me mjedisin, si: ndotja, prishja e ekuilibrave të ekosistemeve, shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore, etj. Mënyra më e mirë për të parandaluar ndotjen e tokës është shfrytëzimi i tokës në mënyrë të organizuar. Ruajtja dhe kujdesi për mjedisin nuk është vetëm një detyrim shoqëror, por mbi të gjitha është dhe një përgjegjësi individuale.